

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                           |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | A mund të mbështetet BE tek SHBA pas samitit në Uashington? – Vizion Plus                                                                                                                 |
| ADRESA  | <a href="https://www.vizionplus.tv/a-mund-te-mbeshtetet-be-tek-shba-pas-samitit-ne-uashington/">https://www.vizionplus.tv/a-mund-te-mbeshtetet-be-tek-shba-pas-samitit-ne-uashington/</a> |
| BURIMI  | vizionplus.tv                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                         |
|-----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 9 shtator 2026, 09:21:51 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                           |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 gusht 2025, 06:38:25 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | bb76533620f1d2eee38c79a3964ba2b4bd0a0001fa96cbc087b065d529dd4205 |
| TEKSTI     | 63cd24ebba3210fd3152d434721662354ade840a2386c342ee04f35a5b338341 |
| PAMJA      | eed6513b1941af2299d1ca8aa29488fa701be287953a3ef0fc98a349970d64b3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                                                                                    |
|----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | c0e96da9310c87e7960725498f44916bc39c1943b79cfa551006906f68328f8b                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA   | c656d0de8ae7a2ea1f03e3582ada40bab9a26e9e95c6d53923bd9b88e6e9a5b2                                                                                                   |
| RRËNJJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI       | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c0e96da9310c87e7960725498f44916bc39c1943b79cfa551006906f68328f8b>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





Mund të mbeshtetesh gjithmonë, paralajmëron Ebert.

Edhe Anthony Gardner, ish-ambasador i SHBA-së në BE gjatë administratës së Barack Obamës dhe tani këshilltar, nuk është shumë optimist se takimi i Uashingtonit do të përmirësojë marrëdhëniet transatlantike, kjo pasi “Trump ende e sheh Evropën si kryesisht të parëndësishme”, thekson Gardner.

Edhe pse politikanët evropianë arritën ta ndryshonin disi narrativën në favor të Ukrainës, takimi nuk arriti të prodhonte ndonjë rezultat domethënës. Gardner gjithashtu pret që evropianët do duhet ta përsërisin këtë, pasi Trump ndryshon mendje “çdo orë”. Në fund të fundit, qëllimi i presidentit aktual të SHBA-së është të arrijë një marrëveshje që është e favorshme për të.

#### **Evropa do të japë kontributin e saj për paqen**

Megjithatë, gatishmëria e SHBA-së për të marrë pjesë në të ashtuquajturat garanci sigurie për Ukrainën konsiderohet përparimi i ditëve të fundit. Flitet për premtime mbrojtjeje të ngjashme me ato në Nenin 5 të Traktatit të NATO-s, ku shkruhet mbi detyrimin për të ofruar ndihmë nëse sulmohet një nga aleatët.

Në Uashington, delegacioni evropian kërkoi të theksonte gatishmërinë e tij për të dhënë kontributin e vet. Për shembull, Presidenti francez Emmanuel Macron iu drejtua Presidentit të SHBA-së: “Mund të jeni të sigurt se Evropa është shumë e vetëdijshme për të dhënë kontributin e saj të drejtë në këto garanci sigurie për Ukrainën – në fund të fundit, siguria e saj është

5 Pas shkarkimit të Kistanit, jep dorëheqjen sekretari i përgjithshëm...

#### **NEWSLETTER**

#### **Përmbledhja e ditës në e-mail**

**Abonohu**

qartësisht në rrezik.”

I ashtuquajtur “koalicioni i të vullnetshmëve”, së bashku me forcimin e ushtrisë ukrainase, ka të ngjarë të jetë një element qendror i garancive të sigurisë në të ardhmen.

### **Cili është “Koalicioni i të Vullnetshmëve”?**

“Koalicioni i të Vullnetshmëve” u krijua disa muaj më parë nga Franca dhe Britania e Madhe. Tani thuhet se ka rreth 30 anëtarë. Sipas Presidentit të Këshillit të BE-së, Antonio Costa, përveç vendeve evropiane, në një konferencë telefonike të këtij grupi morën pjesë edhe Kanada, Turqia, Japonia dhe Zelanda e Re. Pas përfundimit të luftimeve në Ukrainë, do të vendosen “trupa sigurie”, që kanë për qëllim të ndihmojnë në rindërtimin e forcave tokësore ukrainase dhe të sigurojnë hapësirën detare dhe ajrore të Ukrainës, njoftoi bashkëkryetari Keir Starmer në korrik.

Eksperti Ebert e sheh “koalicionin e të vullnetshmëve” si një “sinjal politik ndaj Uashingtonit” se Evropa është e gatshme të marrë më shumë përgjegjësi dhe të kundërshtojë narrativën amerikane se evropianët po mbahen në kurriz të SHBA-së. Ish-ambasadori Anthony Gardner pohon se nga evropianët “po vijnë veprat pas fjalëve tanimë”.

Kjo është e rëndësishme, por gjithashtu kërkoj shumë kohë. Sjellja e Evropës ndoshta nuk është pa interes. Eksperti i sigurisë Ebert thotë se motivi tjetër i evropianëve është gjithashtu t’i mbajnë amerikanët në anën e tyre.

### **Pa SHBA nuk ka zgjidhje**

Një gjë është e qartë: Pa amerikanët, garancitë e sigurisë të lartpërmendura do të jenë të vështira të realizohen, nëse jo të pamundura. Analisti politik Ebert i tha DW se evropianët janë të varur nga SHBA-të si për mbrojtjen ajrore dhe raketore, edhe misionin e zbulimit dhe transportin strategjik ajror. Pra ata kanë nevojë për amerikanët si siguri. Evropa nuk është në gjendje të mobilizojë një forcë mjaftueshëm të madhe për të mbrojtur në mënyrë efektive një armëpushim të mundshëm. Prandaj, duhet të jetë e qartë, se SHBA-të do të ndërhyjnë nëse ndodh diçka, thekson Ebert.

Aktualisht po punohet për të formuluar garancitë e sigurisë. Sipas burimeve britanike, një takim midis SHBA-së dhe përfaqësuesve të “Koalicionit të të Vullnetshmëve” është planifikuar të zhvillohet në ditët në vijim.

### **Trump pret trupa tokësore evropiane**

Një çështje e ndjeshme këtu janë “trupat në terren”, pra a duhet të ketë trupa tokësore evropiane në Ukrainë. Ndërsa kryeministri britanik Keir Starmer ka deklaruar qëllimin e tij për të dërguar trupa në Ukrainë, qeveria gjermane ende nuk ka marrë një qëndrim përfundimtar për këtë çështje. Rusia kundërshton vendosjen e trupave të NATO-s në Ukrainë.

Ish-ambasadori amerikan Gardner kritikoi faktin se, ndonëse është folur shumë për këtë çështje duket sikur do të bëhet fjalë në fund për shumë më pak. Edhe pas shumë muajsh, është ende e paqartë se për çfarë është e gatshme të kontribuojë Evropa. Duke e varur tek njëri-tjetri gatishmërinë e tyre për të vepruar evropianët dhe amerikanët po e zhvendosin përgjegjësinë sa andej këtej.

Në një intervistë me televizionin amerikan Fox News, Donald Trump i bëri të qarta pritjet e tij nga Evropa: Ai pret që Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe të dërgojnë trupa tokësore. SHBA-të janë të përgatitura të ofrojnë mbështetje, për shembull, nga ajri. Çështja e trupave tokësore mund të jetë, pra, testi i radhës për marrëdhëniet transatlantike./dw



**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Më shumë opinione

OPINION

**Çfarë do të thotë kapja e Maduros për...**

Xhuljana Zhuleku 6 Jan

OPINION

**Dronët ukrainas që po godasin arkën e luft...**

Xhuljana Zhuleku 1 Dhj

OPINION

**"Lokalet" në Kosovë do të sjellin ndryshi...**

Xhuljana Zhuleku 11 Tet



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



### Lajme

Politikë  
Bota  
Vendi  
Kronikë  
Lifestyle

### Programe

Programe  
Seriale  
Guida TV  
Video  
Ekipi i Vizion Plus

### Rrjeti

Rreth nesh  
Karriera  
Kontakt  
Reklamo me ne  
Dërgo lajmin tënd

### Ligjore

Kushtet e përdorimit  
Privatësia  
Cookies  
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.